

Vaksinimet për Fëmijët e Shkollave

Peel Public Health sipas ligjit – **duhet** — të mbajë një regjistër të azhornuar me të dhënat për vaksinimet e fëmijeve tuaj të moshës shkollore për gjatë gjithë viteve të shkollës¹.

Kur regjistroni fëmijët në shkollë

- Bashkangjitini një kopje të vaksinimeve që ka bërë fëmija tuaj formularit të regjistrimit në shkollë. Shkolla i dërgon këto kopje në Peel Public Health.
- Bëni kujdes që në këto kopje të përfshihen gjithë dozat e vaksinimeve që ka bërë fëmija juaj qysh nga materniteti.
- Pyesni mjekun e familjes ose i telefononi Peel Public Health në rast se fëmija juaj nuk është vaksinuar ose në rast se ju nuk i keni dokumentat e vaksinimeve të bëra.

Vaksinimet në kohën e duhur

- Në moshën nga katër deri në gjashtë vjeç fëmija juaj ka nevojë për një dozë përforcuese për difterinë, kollën e bardhë, tetanozin dhe poliomilitin².
- Në moshën 14 deri më 16 vjeç fëmija juaj ka nevojë për një vaksinë përforcuese për difterinë, kollën e mirë dhe tetanozin².
- Vaksinimet duhen bërë në kohën e duhur që të bëjnë efektin e duhur. Për shembëll, doza e parë e vaksinës MMR (për fruthin, shytat dhe rubeolën) i bëhet fëmijës **mbasi** të ketë mbushur një vjeç dhe doza e dytë, të paktën 28 ditë pas të parës².

- Peel Public Health kontrollon vazhdimisht kartelat e vaksinimit të fëmijeve për t'u siguruar që dokumentat e tyre janë të azhornuara në mënyre që të lejohen të vazhdojnë shkollën.
- Nxënësit që nuk kanë një dokumentacion të rregullt (dhe nuk kanë një justifikim të pranueshëm) mund të mos lejohen të vazhdojnë shkollën.
- Një fëmijë që nuk është vaksinuar në Ontario ose Kanada mund t'i kërkohej që të ri-vaksinohet për të përmbushur kërkesat e ligjeve për vaksinimet.
- Vaksinimet e domozdoshme për të mundësuar pjesëmarrjen në shkollë bëhen **pa shpërblim** tek mjeku i familjes.
- Përkthimet e dokumentave tuaja të vaksinimeve nga një vend tjetër mund të përkthehen **falas** nga Peel Public Health.
- Një fëmijë i moshës shkollore që nuk ka akoma Health Card (Kartën e shëndetit në Ontario, por që ka nevojë për Vertetim vaksinash mund të vaskinohet **falas** në qendrat e Peel Public Health.
- Peel Public Health ka dhe klinika vaksinimesh nëpër shkolla për Hepatitin B dhe Meningococcal C (për nxënësit e klasave të 7ta) dhe Human Papillomavirus (për nxënësit e klasave të 8ta).

1. Ligji mbi Vaksinimin e fëmijëve të shkollave, Shtator1990. Queens Printer per Ontarion.

2. Udhëzues mbi Vaksinat në Kanada. Botimi i 7të. 2006. Botuar nga Public Health Agency of Canada. : 93/95&196/200.

Mbajeni gjithnjë të azhornuar kartën e vaksinimeve të fëmijës tuaj

- As mjeku i familjes dhe as shkolla nuk kanë për detyrë që të dërgojnë të dhënat për vaksinimet për fëmijet tuaj në Peel Public Health.
- Me t'u regjistruar fëmija në shkollë, **ju duhet të azhornoni kartën e vaksinimeve të tij me Peel Public Health** çdo herë që fëmija vaksinohet.
- **Telefoni** Peel Public Health në 905-799-7700; banorët e Caledon mund të telefonojnë në 905-584-2216 pa pagese. **Mund të kërkoni edhe përkthime.**
- **Vizitoni** www.immunizepeel.ca për të dërguar me kompjuter dokumentat e vaksinimit të fëmijës tuaj.
- **Dërgoni me postë ose silleni dorazi një kopje të dokumentave të vaksinimit në adresën:**
7120 Hurontario Street, P.O. Box 630
Mississauga, ON L5M 2C5
(MOS dërgoni origjinalin)